



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1227 Prot.

Shkodër, më 19.01.2026

**RAPORT MBI PUNËN E KËSHILLIT TË BASHKISË PËR 12 - MUJORIN E VITIT
2025**

Të nderuar këshilltarë,

Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimmarrës i qeverisjes bashkiake, ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse dhe ligjshmërisë, si dhe duke përdorur me **ekonomi, efikasitet dhe efektivitet** burimet njerëzore, financiare, fizike, natyrore dhe teknologjike të Bashkisë.

Veprimtaria e Këshillit Bashkiak mbështetet në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligjet, aktet nënligjore në zbatim të tyre, si dhe rregulloret e miratuara nga vetë Këshilli, si më poshtë:

1. **Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998**, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, *i ndryshuar*.
2. **Ligji nr. 8548, datë 11.11.1999**, “Për ratifikimin e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore”.
3. **Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008**, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, *i ndryshuar*.
4. **Ligji nr. 139, datë 17.12.2015**, “Për vetëqeverisjen vendore”, *i ndryshuar*.
5. **Ligji nr. 44, datë 30.04.2015**, “Kodi i Procedurave Administrative”, *i ndryshuar*.
6. **Ligji nr. 8480, datë 27.05.1999**, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.
7. **Ligji nr. 107, datë 27.10.2016**, “Për Prefektin e Qarkut”, *i ndryshuar*.
8. **Ligji nr. 119, datë 18.09.2014**, “Për të drejtën e informimit”, *i ndryshuar*.
9. **Ligji nr. 146, datë 30.10.2014**, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.
10. **Ligji nr. 68, datë 27.04.2017**, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, *i ndryshuar*.
11. **Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008**, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.
12. **Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008**, “Për barazinë gjinore në shoqëri”.
13. **Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010**, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, *i ndryshuar*.
14. **Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003**, “Për arkivat”.
15. **Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005**, “Për parandalimin e konfliktit të interesave”, *i ndryshuar*.
16. **Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010**, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, *i ndryshuar*.
17. **Ligji nr. 138, datë 17.12.2015**, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, *i ndryshuar*.

18. **Ligji nr. 45/2019**, “Për mbrojtjen civile”, *i ndryshuar*.

19. **Rregullorja** e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak Shkodër, miratuar me Vendimin nr. 60, datë 28.12.2020.

Më poshtë po paraqesim disa nga aktivitetet e Këshillit Bashkiak Shkodër për vitin 2025:

Vendimmarrja

Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar disa mbledhje të komisioneve, me një pjesëmarrje të ulët të këshilltarëve. Numri më i madh i mbledhjeve i përket komisioneve të përhershme, si: Komisioni i Financave, Buxhetit dhe Aseteve Publike, Komisioni i Shërbimeve Sociale dhe Strehimit, Komisioni për Çështjet Ligjore, Komisioni i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, si dhe Komisioni i Rendit Publik dhe Mbrojtjes Civile.

Për periudhën **Janar–Dhjetor 2025**, janë mbajtur **12 mbledhje të Këshillit Bashkiak**, në të cilat janë miratuar gjithsej **85 vendime**. Për këto vendime, Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër është shprehur pozitivisht lidhur me ligjshmërinë e tyre. Nuk ka pasur asnjë akt të kthyer nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër. Numrin më të madh të vendimeve e përbëjnë vendimet që lidhen me projekte prioritare të Bashkisë, si dhe projekte bashkëpunimi të Bashkisë me ministrinë e linjës.

Vlen të theksohet se nga Prefektura e Qarkut Shkodër është kryer kontrolli sipas legjislacionit në fuqi dhe, në raportin përfundimtar të datës **13.06.2025**, është konstatuar se Këshilli Bashkiak Shkodër ka zbatuar me korrektësi të gjitha detyrimet ligjore. Si rrjedhojë, vendimmarrjet e Këshillit pasqyrojnë qartë bashkëpunimin me administratën e Bashkisë për t’iu përgjigjur në kohë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi shqetësimeve dhe problematikave të komunitetit të Shkodrës.

Këshilli Bashkiak, gjatë periudhës 12-mujore të vitit 2025, ka qenë aktiv për sa i përket mbledhjeve të zhvilluara, sipas tabelës së mëposhtme:

Muaji	Nr. i mbledhjeve	Mbledhje e rradhës	Mbledhje jashtë rradhe	Vendi i zhvillimit	Nr.vendimeve të marra
Janar	1	1 (30.01.2025)	-	Salla e mbledhjeve të Këshillit	10
Shkurt	-	-	-	-	-
Mars	1	1 (03.03.2025)	-	Salla e mbledhjeve të Këshillit	9
Prill	1	1 (08.04.2025)	-	Salla e mbledhjeve të Këshillit	5
Maj	2	1 (07.05.2025) 1 (29.05.2025)	-	Salla e mbledhjeve të Këshillit	13

Qershor	1	1 (25.06.2025)	-	Salla e mbledhjeve të Këshillit	10
Korrik	-	-	-	-	-
Gusht	1	1 (04.08.2025)	-	Salla e mbledhjeve të Këshillit	7
Shtator	1	1 (25.09.2025)	-	Salla e mbledhjeve të Këshillit	6
Tetor	1	1 (31.10.2025)	-	Salla e mbledhjeve të Këshillit	8
Nëntor	1	1 (27.11.2025)	-	Salla e mbledhjeve të Këshillit	10
Dhjetor	2	1 (18.12.2025)	1 (29.12.2025)	Online (Zoom Meeting)	7

Mund të përmenden si vendime kryesore gjatë vitit të kaluar:

- Vendime mbi përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar (deri në 6%) për ndihmën ekonomike.
- Vendime për akordimin e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri.
- Vendime për miratimin e Buxhetit të Bashkisë.
- Vendime për subvencionimin e qirasë.
- Vendime për miratimin e planeve dhe rregulloreve të ndryshme.
- Vendime për monitorimin e buxhetit.
- Vendime për mbarimin e mandatit.
- Vendime për dhënien e mandatit.
- Vendime për shtesa dhe ndryshime në buxhet, me qëllim rritjen e efikasitetit të burimeve financiare.
- Vendime për dhënien e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar.
- Vendimi për miratimin e kalendarit dhe planit të aktiviteteve dhe konsultimeve, si dhe buxhetit të Këshillit Bashkiak.

Gjithashtu, Këshilli Bashkiak ka marrë edhe vendime të tjera që lidhen me mbarëvajtjen e punës së Bashkisë Shkodër.

Mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë frekuentuar mesatarisht nga **rreth 40 këshilltarë për çdo mbledhje**. Megjithatë, ka këshilltarë që nuk kanë qenë rregullisht të pranishëm në mbledhjet e Këshillit, çka ka ndikuar në mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij.

Sa i përket mbledhjeve të komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak, duhet theksuar se ato nuk janë zhvilluar rregullisht për shkak të mungesës së kuoromit, duke krijuar vështirësi në zhvillimin normal të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak. Mospjesëmarrja në komisione ka sjellë diskutime të zgjatura dhe të detajuara mbi secilin nga projektvendimet e paraqitura për shqyrtim dhe miratim. Në mbledhjet e komisioneve, këshilltarët kanë mundësi të njihen me detaje për çdo projektvendim të paraqitur, të kërkojnë sqarime nga stafi i Bashkisë, si dhe të bëjnë propozime për përmirësimin e projektaktit. Diskutimi i detajuar i projektvendimeve në mbledhjet e

Këshillit Bashkiak sjell zgjatjen e tyre dhe mosinformimin e plotë të qytetarëve mbi çështjet që diskutohen. Në mbledhjet e Këshillit Bashkiak, këshilltarët duhet të fokusohen në diskutimin e politikave dhe jo në detaje të hollësishme apo gabime drejtshkrimore të projektvendimeve.

I gjithë dokumentacioni i projektvendimeve të shqyrtuara dhe vendimeve të marra gjatë mbledhjeve të Këshillit Bashkiak është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, për t'u dhënë mundësi qytetarëve të njihen me to. Në regjistrin online për transparencën e mbledhjeve të Këshillit janë të dokumentuara të gjitha informacionet përkatëse, duke përfshirë thirrjet e mbledhjeve, oraret e zhvillimit, videot e mbledhjeve dhe procesverbalet përkatëse.

Mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë transmetuar drejtpërdrejt online përmes pajisjeve të instaluar nga Këshilli, në faqen zyrtare në Facebook të Këshillit Bashkiak, si dhe në mediat lokale. Kjo i ka dhënë Këshillit Bashkiak pavarësi në transmetimin e pandërprerë të mbledhjeve dhe ka rritur nivelin e transparencës në lidhje me vendimet e marra dhe çështjet e trajtuara në funksion të interesit të qytetarëve.

Kërkesat dhe ankesat e qytetarëve

Në Këshillin Bashkiak Shkodër, për periudhën **Janar–Dhjetor 2025**, janë regjistruar **31 kërkesa**, të cilat janë trajtuar në mbledhjet e Këshillit Bashkiak dhe nëpërmjet komunikimit shpresor. Pjesa më e madhe e kërkesave ka pasur të bëjë me emërtime rrugësh, kërkesa për informacion, kërkesa për tituj nderi, si dhe ndërhyrje në infrastrukturë.

Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur peticione apo nisma qytetare të depozituara pranë Këshillit Bashkiak. Këshilli Bashkiak, në koordinim me Bashkinë Shkodër, është angazhuar t'u japë përgjigje të gjitha shqetësimeve të qytetarëve, brenda mundësive dhe kornizës ligjore. Kërkesat dhe ankesat janë publikuar në regjistrin online të kërkesë-ankesave në faqen zyrtare të Këshillit Bashkiak.

Gjithashtu, në çdo mbledhje plenare të radhës, në përfundim të saj, është lënë një hapësirë për pyetje nga komuniteti (kërkesa apo ankesa), të cilat janë përcjellë përmes pyetjeve të paraqitura nga këshilltarët drejtuar administratës së Bashkisë dhe kanë marrë përgjigje të drejtpërdrejta nga kjo e fundit. Për rrjedhojë, del si detyrë që çdo këshilltar, për aktet normative që do të diskutohen dhe miratohen në Këshill, të marrë paraprakisht opinionet dhe vërejtjet publike në lagjen ose fshatin që përfaqëson.

Konsultimi me publikun

Sekretariati i Këshillit Bashkiak ka zbatuar me korrektësi kërkesat ligjore për njoftimin publik, si përmes faqes zyrtare të Bashkisë Shkodër, komunikimit elektronik me drejtoritë e Bashkisë dhe kryetarët e njësive administrative, ashtu edhe në këndin e informimit pranë zyrës së marrëdhënieve me publikun, në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe Rregullores së organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak Shkodër. Këshilli Bashkiak i ka kushtuar vëmendje të veçantë dëgjësive publike për projektaktet për të cilat kërkohet konsultim sipas ligjit. Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar **8 konsultime publike për 8 projektakte**.

Në këto dëgjesa kanë marrë pjesë gjithsej **585 qytetarë**, përfshirë përfaqësues të bizneseve, grupeve të interesit dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak. Të gjitha informacionet për konsultimet me publikun janë publikuar në regjistrin online për konsultimet publike në faqen zyrtare të Këshillit Bashkiak.

Kryesisht, kërkesat e qytetarëve kanë qenë të lidhura me përmirësimin e infrastrukturës së shkollave, kopshteve dhe çerdheve, përmirësimin e infrastrukturës rrugore, përmirësimin e shërbimeve publike të ujësjellës-kanalizimeve, menaxhimit të mbetjeve, zgjerimit të rrjetit të ndriçimit publik, pastrimit të kanaleve kulluese dhe vaditëse, shtimit të hapësirave rekreative për të rinjtë, përmirësimin e transportit urban dhe lidhjen e tij me rrjetin rural, si dhe shërbime në favor të bizneseve që operojnë në sektorin e turizmit.

Numri i rekomandimeve të dala nga këto takime është **436**, prej të cilave **67% janë reflektuar** në vendimet e marra nga Këshilli Bashkiak.

Më poshtë lista e dëgjesave të mbajtura:

Nr	Titulli i projektvendimit	Nr. seancave	Nr. Pjesëmarrësve	Nr. Rekomandimeve
1.	Për projektbuxhetit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm 2026-2028.	12	444	409
2.	Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për licensimin e agjencie funerale/shtëpi funerale (salla pritje), në territorin e Bashkisë Shkodër.	1	19	5
3.	Për miratimin e rregullores së përdorimit të hapësirave publike të Bashkisë Shkodër.	1	21	4
4.	Për miratimin e planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore” “Rosek Drisht ” dhe “Drin Gjadër Kir”, Bashkia Shkodër.	1	0	0
5.	Për miratimin e vlerës së tarifës ditore për shfrytëzimin e setit çadër (plazh) + 2 (dy) shezlong në plazhin e Velipojës	1	21	3
6.	Për disa ndryshime dhe shtesa në VKB nr.1, datë 22.01.2025 “Për Taksat dhe Tarifatat vendore në Bashkinë Shkodër”, i ndryshuar	1	48	5
7.	Plani i Lëvizshmërisë së Qëndrueshme Urbane për Shkodrën ”.	1	32	10
8.	Për miratimin e planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore” “Rosek Rrjoll ” Bashkia Shkodër	1	0	0

Aktivitetet kryesore të Këshillit

Këshilli Bashkiak Shkodër, gjatë vitit 2025, ka realizuar shpenzimin e 80.7% të buxhetit të planifikuar. Pjesa më e madhe e këtij buxheti është përdorur për honoraret e këshilltarëve, organizimin dhe zhvillimin e dëgjësive publike, hartimin e projektakteve të ndryshme, si dhe për shpenzime kancelarie dhe shpenzime të tjera të domosdoshme për mbarëvajtjen e aktiviteteve të Këshillit Bashkiak.

Në vijim, Këshilli Bashkiak ka miratuar Planin e Aktiviteteve, Vendimmarrjes dhe Konsultimeve për vitin 2026, i shoqëruar me një buxhet të planifikuar prej 20.531 mijë lekë.

Këshilli Bashkiak Shkodër komunikon në mënyrë të vazhdueshme me qytetarët përmes rrjeteve të tij sociale, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Nëpërmjet këtyre kanaleve, qytetarët ftohen të angazhohen në dialogun me qeverisjen vendore, të përdorin instrumentet ligjore dhe institucionale të Këshillit për adresimin e problematikave të tyre, si dhe të parashetrojnë kërkesa apo ankesa.

Gjithashtu, qytetarët kanë mundësi të ndjekin mbledhjet e Këshillit Bashkiak online dhe të marrin pjesë në dëgjësat publike që organizohen për projektakte të ndryshme apo për buxhetin e Bashkisë.

Të gjitha këto informacione janë të aksesueshme për konsultim në faqen zyrtare të internetit të Këshillit Bashkiak Shkodër.

Të gjitha këto informacione mund të konsultohen në faqen tonë të web:

<https://bashkiashkoder.gov.al/>

ose në rrjetet tona sociale facebook

Këshilli Bashkiak Shkodër: <https://bashkiashkoder.gov.al/keshilli-bashkiak/>

SEKRETARE

Sabina DANAJ

KRYETAR

OLTION LULI

